



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për komunitete

01Nr. 06-14539 2024

Klinë, dt. 09. 02. 2024 29.09.2024

### PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e Komitetit për komunitete të mbajtur me datë 09. 02. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

Mbledhjen e hapi kryesuesja e Komitetit znj. Besiana Gashi e cila përshëndeti anëtarët e komitetit si dhe i uroj mirëseardhje drejtorit të Urbanizmit z. Enver Berisha. Më pastaj prezantoi rendin e ditës.

Rendi i ditës me vota unanime U MIRATUA.

Pika 1 e Rendit të ditës: Arsyetimi i mungesave: Të pranishëm në mbledhje janë 6 -shtë anëtarët e komitetit, znj. Marigona Kerrellaj do të bashkëngjitet mbledhjes në vazhdim.

Pika 2 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

- Procesverbali i mbledhjes së kaluar u Miratua pa asnjë vërejtje me 6 vota për.

Pika 3 e Rendit të ditës: Informim nga drejtorja e Urbanizmit lidhur me projektet e infrastrukturës në mjediset e komunitetit.

z. Enver Berisha , drejtor i urbanizimit: Përshëndetje të gjithëve. Do të ndalem në pika të shkurta në projektet e realizuara në vendbanimet e komunitetit. Në vitin 2021 kemi ndërtuar asfalt dhe ndriçim në Budisalc tek familjet Alaj dhe Abazaj, Në Klinac tek familja Itaj, Vrankaj dhe familjet e kthjera, asfaltim dhe ndriçim. Gjithashtu rrugët dhe infrastrukturën në tokësore në Dresnik dhe Shtupel. Në vitin 2022 në Shtupel tek lagja Kerrellaj, në dresnik tek familja Abazaj. Tek lagja Mahalla ndriçim, në Jagodë , në Drenoc tek komuniteti, në Budisalc disa pjesë të rrugëve të komunitetit Rom, pastaj ne kemi aplikuar në ministri për projekt në bashkëfinancim në vlerë prej 95000 euro. Secilin projekt që kemi realizuar nëpër fshatra nuk kemi bërë ndarje përjashto ato që kanë qenë në bashkëfinancim dhe të veçanta për komunitete.

Drejtori vazhdoj tutje duke përmendur të gjitha projektet ndër vite të realizuara në vendbanimet e komuniteteve.

z. Vehbi Alaj: Përshëndetje. Thatë që është punuar në Budisalc rruga tek familja Alaj dhe Abazaj, a është planifikuara që të vazhdohet rruga edhe tek familjet në fund të lagjes që ju duhen vetëm 70

metra asfalt për tu lidhur me rrugën kryesore. Tek Familja Abazaj ka dy vite që nuk ka qasje në kanalizim.

Z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Ne këtë vit kemi para paraparë që në Budisalc, Rudicë dhe pjesë të tjera të investojmë rreth 50 mijë euro, besoj që do të i përfshijmë edhe ato pjesë që ju sapo i përmendet. Sa i përket familjes Abazaj nëse nuk përfshihet në këtë investim do të përfshihet në buxhetin e vitit të ardhshëm por gjithsesi për fshatin Budisalc jemi duke pritur përgjigjen nga Ministria për aplikimin që kemi bërë.

z. Djuro Krasic: Përshëndetje. E shoh që Gremnikun nuk e keni përmendur. Jam bërë i bezdisshëm për kolegët e tu duke kërkuar urë, rrugë e kanalizim. Në 2018 është aprovuar tenderi për ndërtimin e urës, e ka fituar një kompani por asnjë punë nuk është bërë. Njëjtë edhe për kanalizim që 13 vjet nuk kemi kanalizim, Vetëm 200 metra duhet që të instalohet kanalizimi nëpër pronat tona. Binak Sylaj ka premtuar që deri në fund të vitit 2023 do të përfundoj kjo por asgjë s' ka ndodhur. Do të doja që të aktivizoheni më shumë rreth Gremnikut.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Ne kemi menduar që po përfitojmë ndonjë projekt për fshatin Gremnik por nuk ka ndodhë. Do të mundohemi që të ndajmë mjetet nga buxheti që është për nevojat e qytetarëve dhe ta rregullojmë atë punë. Nuk është i përfshirë Gremniku në aplikacion por kërkesa e juaj do të transmetohet edhe në drejtori të tjera dhe të gjejmë një mënyrë që të ju ndihmojmë. Gjithsesi kanalizimi duhet të kalojë nëpër pronat e juaja që mos të kemi probleme me pronar të tjerë. Duhet parë edhe shkarkimin e kanalizimet sepse shtëpitë e juaja janë në nivel më të ulët por këtë do ta shikojnë gjeodetët. Nuk ju kemi harruar, por projekti është i vogël e kërkesat janë të mëdha. Nuk kemi bërë ndarje asnjëherë dhe nuk do të bëjmë.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Dëshiroj ta pyes drejtorin për dy çështje. Tek familja Zeqa në Bokshiq e pashë që është shtruar rruga por ajo është bërë vitin e kaluar. Shqetësimi i banorëve është se rruga kryesore është shtruar por rrugicat nëpër lagje ata ishin detyruar të paguajnë kesh. A ja kanë paguar komunës apo kompanisë nuk e di. Çështja tjetër është se a jeni në dijeni se disa rrugë në fshatin tim Caravik, janë shtruar vitin e kaluar por janë bërë kapërcime. Kalohen dy tre familje e shtrohet një. Janë lënë rrugët që janë afër shtëpive dhe janë shtruar rrugë afër arave, nuk e diji a është shtruar për interes të ndokujt. Ajo rrugë e arave shfrytëzohet vetëm nga bujqit më shkuar me traktor. Kjo më shqetëson.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Sa i përket lagjes Zeqaj nuk kam informacion që banorët kanë paguar mjete. Nëse kanë bërë pagesa duhet të hetohet nga organet. Nëse Banorët kanë dashur që të zgjerojnë rrugët e tyre private ne nuk mundemi të ja ndalim marrëveshjen atyre me operatorin. Por nëse nga komuna ju ka marr mjete për shtrirje të asfaltit, kjo punë duhet hetuar nga organet përkatëse. Ne si Komunë nuk kemi këtë informacion por do ta verifikojmë. Për Caravik, mos të keni hamendje që janë shtruar të gjitha rrugët. Ka akoma rrugë të pa shtruara. Në Caravik është punuar në dy faza, por nuk arsyetohet se pse nuk ma ka shtruar rrugën para shtëpie një rrugë e dy rrugë. Unë mendoj se në Caravik është punuar pak më shumë se sa në vendet e tjera. Mund të ndodhë raste kur dikush ka kërkuar që ose me ja shtruar komplet ose hiç. Rruga e arave që thoni mendoj që është me zhavorr por nëse është asfalt mendoj që çdo rrugë është mirë të shtrohet.

z. Arben Limanaj: Po por prioritet është të shtrohen rrugët ku banojnë qytetarët.

z. Enver Berisha, drejtor: Unë dëshiroj që të përmyll me shtrirjen e asfaltimit të të gjitha rrugëve por dëshira dhe mundësia nuk qëndrojnë gjithmonë bashkë. Nuk e diji që kemi bërë ndonjë dallim, jam shumë kundër dallimeve. Mund të ndodhë që ndonjë familje nuk jeton aty fare. Kemi edhe pengesa të shumta, qytetari nuk dëshiron që ta kthej rrugën në pronësi të komunës etj. Unë kam ardhë në Caravik por skam pa rrugë të pa shtruar ose që është anashkaluar.

z. Arben Limanaj: Shkojmë bashkë dhe e sheh, tre axhallarët e mijë janë anashkaluar dhe ka vazhduar asfaltimi ën ara.

Znj. Silvija Raskovi: Dëshiroj që ta pyes drejtorin për një kërkesë nga Krysheva e madhe për dy rrugë , një 40 metra dhe një tjetër 100 metra. Janë rrugë ku jetojnë serbet. Ju thatë që nuk keni bërë dallim por janë këto dy rrugë që tregojnë të kundërtën. Pyetja a do të kryhen këtë vit? Po ashtu njëjtë edhe në fshatin Drenoc asnjë zhvillim asnjë rrugë aty ku jetojnë serbet tash e dy vite nuk është kryer.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Unë kam qenë dhe e kam vizituar ato dy rrugë. Ato janë në projekt dhe do të kryhen e kam kthyer edhe përgjigjen me kohë. Sa i përket Drenocit nuk kam informacione. Zakonisht pyesim përfaqësuesit e fshatrave për projektet e nevojshme. Rrugët ju shtrohen të gjithëve pavarësisht përkatësisë etnie e fetare.

z. Vehbi Alaj: Faleminderit për punën dhe angazhimin korrekt por a keni në projekt ndërtimin e Urës që lidhe Fshatin Rudicë dhe Budisalc.

z. Enver Berisha, drejtor: Rruga "Anton Çeta" është e gjate 150 metra, e diji hallin e qytetarëve, ajo te paktën do të shtrohet me zhavorr pastaj me asfalt. Sa i përket urës, ajo ka kosto më të madhe se sa që kemi ne mundësi por në Rudicë është në projekt dhe do të bëhet.

z. Nexhemedin Gashi: përshëndetje për të gjithë. Çështja e kanalizimeve, dëshiroj një pyetje drejtorit. Vitin e kaluar Familja Abazaj në Dresnik kishin problem me kycje në kanalizim nuk e diji a ka përfunduar a ka bërë zgjidhje Komuna. Prej Këtij viti do të filloj edhe pagesa për kanalizim që do ta faturoj Hidrodrini prandaj është mirë që të përfundohen kanalizimet. Dëshiroj të diji edhe për çështjen e legalizimit se ku qëndron ky proces, a ka filluar a ka mbaru afati.

z. Enver Berisha, drejtor: Në Dresnik dhe Dolc është një teren shumë i gjerë dhe është bërë një zhvillim i hovshëm. Në Dresnik ka disa vende që është vështir të arrihet niveli i derdhjes së ujërave sepse Dresniku është në një nivel me lumin, nuk është aq lehtë. Po ashtu kemi probleme atje me hapësirat private nga kalon kanalizim duke mos pasur mundësi shpronësimi i të gjithë asaj vije nga kalojnë kanalizimet. Sa i përket legalizimit, ai është hapur në shtator dhe ka afat dy vjeçar. Ju lutna që të mos vonohen dhe mos ta lëshojnë këtë rast. Janë kriteret që duhet pasur për legalizim. Kemi një zyrtare që po merret ekskluzivisht me legalizimin. Shtëpitë që janë deri në 2004 janë pa pagesë ndërsa ato që janë ndërtuar deri në 2018 janë me një pagesë simbolike. Pas 5 shtatorit 2018 nuk e përfshinë ky proces.

Znj. Besiana Gashi: Dëshiroj edhe unë të diji për fshatin Çabiq pse nuk është vazhduar instalimi i ndriçimit në rrugën "Adem Buzhala". Po ashtu pse trotuari është lënë në gjysmë e nuk është vazhduar andej nga Zabërgja. Do të doja që projektet që realizohen të kenë më shumë cilësi se sa sasi të projekteve.

z. Enver Berisha, drejtor: Sa i përket ndriçimit publik, vetëm projektet që janë të reja që janë iniciuar nga urbanizmi dhe në përbërje të tyre kanë edhe ndriçimin përndryshe këtë segment e udhëheq Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe jo Urbanizmi. Për trotuar aq kemi pasur mundësi buxhetore ndërsa për cilësi nuk mund ta matim me sy por nga Testet që vijnë nga një kompani e licencuar për atë punë. Unë kam kërkuar gjithmonë që operatorët të bëjnë Atestet rreth asfaltit. Ai e ka për obligim. Por kur ta sjell Atestin nga kompania e licencuar ne nuk mund ta kundërshtojmë. Por asgjë nuk na ndalon që të formojmë një komision të veçantë që A testet e kompanisë të i dërgojmë për verifikim.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Informim nga zyra për komunitete dhe kthim

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Përshëndetje. Pasi morëm disa informata nga drejtori i Urbanizmit dhe përmendi disa projekte që ne i kemi bërë që nga 2022. Pavarësisht kësaj ne bashkëpunojmë me drejtorinë e urbanizmit prandaj edhe ai ka të drejt të jetë pjesëmarrës në këto projekte. Sa i përket zyrës sonë janë e kemi një projekt në bashkëpunim me advancing together në përgatitje. Janë tre projekte të tjera që janë pranuar dhe një të katër që ka të bëjë me gratë rreth organizmit të 8 marsit.

Znj Raskovic shpjegoj në detaje për projektet që janë pranuar dhe pritet të nis implementimi i tyre. Ajo përmendi UNMIK-un si donator i projektit të implementuar nga Advance together. Kemi pasur takime të rregullta sa i përket sigurisë posaçërisht kohën e fundit kur situata ishte e tensionuar kur policia e Kosovës mbyllën komunën paralele në Videnjë. Tha znj. Raskovic.

“ Kemi iniciuar edhe procedurën për zëvendësimin e anëtarit në KKSB dhe angazhimin në të gjitha komitetet e tjera ku kërkohet prania e jonë. Në Gracanicë kemi pasur një takim në lidhje me përgatitjen e plan biznesit për gra. Shkëmbyem edhe përvojat me regjionet e tjera gjithashtu. Po ashtu kemi pasur një trajnim në Istog në lidhje me trajtimin e dhunës dhe ngacmimet seksuale të femrave në familje” ë përmbylli fjalën e saj znj. Silvija Raskovic.

z. Vahbi Alaj: Dje e vërejtëm që janë ndarë mbi 66 multikultivator, a keni ndonjë listë se a ka përfituar ndonjë nga komuniteti. Po ashtu, a po punohet në lidhje me thirrjen e MPL për ndërtimin e shtëpive për minoritetet.

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Nuk kam parë që ka përfituar ndokush nga komuniteti por më kanë premtuar që në rundin e dytë do të përshihet gjithsesi. Këto multikultivator sa e diji unë ka shpërnda Islamic Relief dhe ata i kanë përzgjedhë përfituesit. Sa i përket rindërtimit të shtëpive unë e diji që edhe një javë është afati për aplikim.

z. Nexhmedin Gashi: Sa i përket projekteve që vijnë nga komuna ose nga shoqatat për minoritetet, po futen edhe kriteri i balancimit që po përfitojnë edhe shqiptarët prandaj është mirë që edhe në rastet e tjera të bëhet balancimi.

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Ne i ndihmojmë që të plotësohen dokumentet por nuk ndajmë. Pjesëmarrjen për aplikim nuk ja ndalon askush vetëm se duhet plotësuar kriteret që janë paraqitur.

z. Arben Limanaj: Dëshiroj të diji dhe mos ma merr tendencioze, a keni pasur kontakte me komunën paralele në Vdenjë ju si zyre për komunitete dhe kthim.

Znj. Silvija Raskovic, ZKK: Zyrtarisht nuk kemi pasur as nuk kemi asnjë kontakt, privatisht po sepse me duhet edhe mua të marr dokumente te nevojshme pasi që edhe unë jam e kthyer. Dua të bëjë një lajmërim që tek unë ka ardhur z. Burim Ademi dhe ka kërkuar që të ja sugjerojmë dike të kualifikuar nga komuniteti për të punuar në një TV stacion që do të hapet së shpejti në Klinë.

Me këtë edhe e përfundoj fjalën e saj znj. Silvija Raskovic, shefe e zyrës për komunitete dhe kthim./

Pika 5 e Rendit të Ditës: Të ndryshme

z. Vehbi Alaj: Unë do të doja që për mbledhjen e ardhshme të ftohet përfaqësuesi nga zyra ligjore në Komunë, në lidhje me mos pagesat e anëtarëve të komitetit.

Kryesuesja e shpalli të mbyllur takimin

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuese:

Besiana Gashi